- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organizatës administrative, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP³.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

³ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Nërastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Nëçdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimine ofertës, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratëmbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesionali operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9, pika 1.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit 2017,2018,2019 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku nuk duhet të jete më e vogël se vlera **3,666,647 (Tremilion e gjashtëqind e gjashtëdhete e gjashtë mijë e gjashtëqinde e dyzete e shtate) lekë** (vlerë jo më e ulët se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet) (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes, të përcaktuar në akt marrëveshje).

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).

2.2.4 Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2018, 2019, 2020 lëshuar prej njësisë së vetqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, referuar adresave kryesore dhe dytësore ku është regjistruar sipas QKB,

sipas përcaktimeve në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara për kryerjen e pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore për vitin 2020 (Vërtetimi duhet të ketë si element edhe NIPT-in e subjektit) (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

a. Për të provuar përvojën e mëparshme kërkohen dëshmi për Furnizime të ngjashme me një vlerë jo më pak se 3,666,647 (Tremilion e gjashtëqind e gjashtëdhete e gjashtë mijë e gjashtëqinde e dyzete e shtate) lekë (vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, e vërtetuar me :

- Kontratën përkatëse
- Vërtetimin përkatës nga Autoriteti Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuar, e firmosur nga të dy palët.

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in deklaratë që furnizimi do të bëhet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në Ndermarrjen e Sherbimeve Publike Bashkia Berat.

2.3.3 Materialet duhet të sillen në objekt sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor në vendin e kërkuar . Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë në pronësi ose me qera minimalisht:

- 5 (pesë) kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-18 ton

a. Në rastin kur mjetet janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse.

b. Në rastin kur mjetet janë me qera, të vërtetohet me kontratën e qerasë të noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikatën e transportit të lëshuar nga bashkia përkatëse.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me qëllim verifikimi nga AK.

- a. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë nga momenti i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruara si më sipër

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit si staf teknik:

- 5 Shofere, të pajisur me Dëshmi aftësie profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesa sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- Për shoferet operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës

2.3.6 Gjithashtu Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të disponojnë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me kontratë noteriale qeraje ose me kontratë noteriale furnizimi te vefshme per periudhen deri ne afatin e realizimit te kontrates ,1 (një) Impiant për prodhim inertesh me QKL. Për këtë duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë së impiantit, nëse është marrë me qera kontratë noteriale qeraje, apo kontratë noteriale furnizimi ku të përshkruhet emërtimi i objektit sasitë dhe afati i furnizimit, si dhe deklaratë noteriale e garancisë së prodhuesit, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

- a. QKL–Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Për Impiant Inertesh” me fushë veprimtarie “Prodhim të produkteve abrazive dhe produkte minerale jometalike”.

2.3.7 Për impiantin e prodhimit të Inerteve operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raport testimet per materialet si me poshte:

- a. Raport Testim të Materialeve Inerte Granil, Metoda e Tesimit S SH EN 933-1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012
- b. Raport Testimi të materialeve Inerte Rërë e Larë Metoda e Tesimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Tesitimit S SH EN 933- 1; 2012.
- c. Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025;2006
- d. Raport i testimëve duhet të jetë sipas standarteve në fuqi bazuar në ligjin Nr.9290 date 07/10/2004 “Per Produktet e Ndertimit”. Raport testimet duhet të jenë 6 – mujorin e fundit.

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë certifikatat e cilësisë në gjuhën shqipe, ose të përkthyer dhe të noterizuara si më poshtë

- a. ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme , ose ekuivalent .
- b. ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” e vlefshme, ose ekuivalent

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. ÇAKELL MBETURINE PER MBUSHJE(INERTET)

Cakell makinerie e prodhuar nga thyerja dhe fraksionimi ne makineri I materialeve gurore ose zhavorre lumi me fortesi 800 kg/cm²dhe te respektoje kushtet teknikete Standartit Shqiptar STASH-512-78 dhe te mos kete permbajtjet e huaj argjilore me shume se **5%** dhe material organike jo me shume se **3%**.Rera e makinerise duhet te kete granulometrine (0-5)mm,ndersa çakelli I makinerise (20-60)mm.Cakulli nuk duhet te permbaje mbi 10% grimca te dobeta dhe argjilore.

2. GURE KAVE

Duhet te jene te prodhuara ne kariera guri,te kene fortesi 600-800 kg/cm²,permbajtje te argjiles me pak se 10% dhepermbajtjetembeturinavebimore me pak se 5%. Guret e kaves do te perdoren nga enti prokurues per ndertimin e mureve pritese e mbajtese ne akset rrugore te ti permasat e gurit te kaves jo me pak se 20cm.

3. ÇIMENTO

Duhet te jete “Portland” ,M400 ne thase 50kg. dhe ne perputhje me kushtet e Standartit Shteteror STASH-501-87.Çertifikata e cilesise dhe fletet e analizave te fabrikave qe kane prodhuar çimenton duhet te shoqerojne cdo furnizim sipas porosise se entit kontraktor, duke vertetuar qe çimentoja eshte e testuar dhe ika plotesuar kerkesat e permendura me lart.Transporti ne objektet e magazine duhet te behet nga kontraktori ne paketa origjinale te shenuara direct nga fabrika e prodhimit te çimentos dhe te rruajtura ne kushtet e duhura.

4. STABILIZANTI

Te jete I prodhuar nga material gurore I thyer ,I fraksionuar dhe te plotesoje kerkesat e me poshteme:

- Fortesia e gureve perberes $\geq 800\text{kg/cm}^2$
- Marka e thermimi tngaprovaLosanxhelos $LA \leq 30\%$
- Permbajtja e argjilesderi ne 5% dhematerialeveorganikederi ne 3%

5. ASFALTO BETON GUR KAVE.

Duhet te jete i pregatitur nga lendet lidhese bitum, cakull ne masen 40% dhe rere ne masen 60%.

Te jete I prodhuarnga material gurore i thyer me permasat nga 5-20mm. me permbajtje bitumi jo me pak se 4.5%,densiteti 2.2gr/cm³dhe bitum 50 70.Materiali i gurit qe do teperdoret per granilin e gurit, . Temperatura e Asfaltit ne ne momentin e hedhjes ne objekt duhet te jete 150 grade.Ne perzierjen e gatshme te asfalto betonit nuk lejohet te kete kokrriza te pa mbuluara me bitum. Bitumi qe perdoret per prodhimin e asfaltobetonit si dhe ne asfaltimet e tjera me depertim ose trajtim siperfaqesor, duhet te plotesoje kerkesat e Stash 660-87 ose te STASH CNR Nr. 1996 “Karakteristika per pranim”. Ne kohe te nxehte (vere) keshillohet perdorimi i bitumit me depertim (penetrim) 80 deri 120 ose me pike zbutje 45 deri 50°C, ndersa ne pranvere e vjeshte bitum me depertim 120 deri 200 ose pike zbutje 40 deri 45°C.

6. ZGARE HEKURI

Perdorimiper shtresa betoni ne rrugeduhet te jete me hekur Ø6 mmdhe me permasa te zgares (4.70*2)m.si dhe me permasat kuadratike zgares (25*25)cm.

7. ZHAVOR LUMI

Fraksionuar per betonduhet te jete i paster ne raport 40% zall i fraksionuar dhe 60% rere e lare.

8. TUBO E BRINJEUAR HDPEd= 315mm

Tubat duhet te jene te testuar te durojn presionin minimalisht 16 bar. Diametri I jashtem315-315.8 mm spresori 28-28.6 mm ,ovaliteti max 8.1 mm

Duhet te je ne ne perputhje me standartet e lejuara dhe te mos jene te demtuara.(te cara ose te shtypura) dhe duhet te jene te qenrushme ndaj ngarkesave mbi 8000 kg.

9. TUBO E BRINJEUAR HDPEd= 200 mm

Tubat duhet te jene te testuar te durojn presionin minimalisht 16 bar. Diametri I jashtem 208 mm spresori 28-28.6 mm ,ovaliteti max 8.1 mm

10. PLLAKA BETONI

Pllakat duhet te jene me permasa 30cm*30cm*5 cm ,perberja e pllakave duhet te jete nga cemento, granil,rere.

11. BOJE AKRELIKE PER VIZIME RRUGESH

Sipas standartit 935 te institutit te Izraelit ose cilesi me e mire se kjo.Perparesite tharje ekstremisht e shpejte ,rezistence e larte ndaj goditjeve mekanike,e qendrushme ndaj kushteve klimaterike.Koha e thrjes per tu prekur 10/15minuta dhe tharje e plote per 30minuta.

12. BOJE HIDROPLASTIKE

Te jete cilesore dhe lengu i bojës te perdoret me nje sasi 20-30 % uji. Boja duhet te jete sipas K.T.Z se STASH.

13. ELEKTRODA

Duhet te jene me permasat Ø3.2 celiku.

14. HEKUR BETONI I ZAKONSHEM

Te jete me keto permasa Ø 6 - 10 mm². Duhet te jete Sidenor S 500 ose ekuivalent

15. HEKUR BETONI I ZAKONSHEM (Te jete me keto permasa Ø > 12 mm²) Duhet te jete Sidenor S 500ose ekuivalent

16. HEKUR PROFIL DHE SHIRIT Prodhimi i profileve duhet te je te nga kompani te licensuara.dhe gjate furnizimit duhet te shoqerohet me dokumentin teknik te cilesise.

17. KAPAK ZGARE GIZE

Duhet te jene me permasa 45*70 cmperpuseta KUL . Duhet te jene prej Gize dhe te plote ,te qendrushem ndaj peshve te renda dhe rezistent ne perkulje gjate furnizimit te shoqerohen me certifikate cilesie.

18. GRANILI

Duhet te jete i lare dhe me mje madhesi jo me te madhe se 0.5 cm.

19. BITUME

Duhet te jete cilesore me nje dozim 3.8 per m2 dhe i zbatuar ne te nxeht. Te hollohet me 20/30 % uji.

20. RERA E LARE

Te jete e paster dhe te mos kete perberes te tjere. (porozitet 35%)

21. FINO SOVATIMI

Materiali te jete sips STASH dhe te jete i pajisur me certifikatem e prodhuesit. Te jete me thase 25 kg.

22. GOZHDE

Te jene te pajisura me certifikat cilesie dhe emerin e prodhuesit.me permasa sipas kerkeses.

23. GURE TROKOJE

Te jete gurë prerës metali \varnothing 230 0.55 iop

24. KRIFE

Kripa e gurit ose kripa për shkrirje nuk do duhet të përmbajnë me shumë se 5% të thërmijave me përmasa nën 0.16 mm e as copëza me të medha se 5 mm. Kripa për shkrirje nuk duhet të përmbajë elementë të qëndrueshme ndaj ujit e as përbërës të tjerë që do ta ngadalësonin procesin e shkrirjes.

25. GERQELE E SHUAR

Gëlqere e shtuar në 110 lt .

26. GUR LUMI

Gur duhet te jete jo me i vogel se 20 cm

27. ASTAR (VINOVIL).

Të dhënat materiale: përmbajtja: përzierje akrilike me bazë uji. Tretja: deri në 10% ujë. Aftësia e mbulimit:

28 .DERRAS PISHE duhet te jete e stazhionuar e drejte dhe pa nyjete kete permasa 10×2×400cm

29.BINARE DRURI te jene te stazhionuara te drejta pa nyje dhe me permasa 7×7×300cm.

30.SKELERI METALIKE PER MURE DHE SUVATIME (komplet me H dhe lidhjet me panelat e shtresave)

Te jete material celiku te sigurta komform KTZ se

31.PANELA DRURI (betoforma) Te jene me permasa 250×125cm dhe komforme KTZ se

32. KAPAK GIZE

Duhet te jete me permasat 100x100 cm te jete Ø60.Duhet te jene prej Gize dhe te plote ,te qendrushem ndaj peshve te renda dhe rezistent ne perkulje gjate furnizimit te shoqerohen me certifikate cilesie.

33.Tabelat per sinjalistiken rrugore te jene me material Lllamarina xingato, me veshje fosforeshente.Mbishkrimi i tabelave do behen sipas kerkeses se autoritetit kontraktor.

34. Kyca tops per kasetat elektrike

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë

kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktornë Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVENËMARRËVESHJENKUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<hr/>		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	<hr/>	<hr/>
02	<hr/>	<hr/>
03	<hr/>	<hr/>
...	<hr/>	<hr/>

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë nërastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatërihapjes sëprocesit tëmini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi I punimit	Njesia	Sasia
1	Çimento 32.5 R	kg	87000
2	Zgara hekuri Ø6 (5x2) m	cope	350
3	Bitum M- 3 leng	kg	396
4	Asfaltobeton guri kave	ton	230
5	Zhavor lumi Fraksionuar per beton	m3	250
6	Rere e lare	m3	250
7	Gur kave	m3	320
8	Gur Lumi	m3	100
9	Çakell mbeturine per mbushje	m3	6700
10	Tel bari	kg	120
11	Tube e brinjezuar HDPE d=315mm	ml	50
12	Tube e brinjezuar HDPE d=200mm	ml	400
13	Tumbino betoni	cope	7
14	Gozhde	kg	100
15	Pllaka betoni 30 x 30 x 5 cm	m2	300
16	Granil (0.5cm)	m3	50
17	Boje Akrelike Per Vizime rruges	kg	250
18	Boje hidroplastike cilesia e I re	kg	100
19	Elektroda	kg	120
20	Hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm2	kg	500
21	Hekur betoni i zakonshem Ø > 12 mm2	kg	200
22	Dadi dhe bulona	kg	50
23	Gerqele e shuar	ton	1
24	gur trokoje	cope	86
25	Kapak zgare gize (45*70) Puseta KUL	cope	49
26	Kapak gize100x100&Ø60cm	cope	8
27	Stabilizant (Tampon)	m3	140

Dokumentat Standarde të Tenderit

28	Derrase pishe	m3	4
29	Binare druri pishe	m3	2
30	Skeleri metalike per mure dhe suvatime (komplet me H dhe lidhjet me panelat e shtresave)	cifte	20
31	Kyca tops per kasetat elektrike	cope	70
32	mentesha per kasetat elektrike	cope	40
33	Panela druri (betoforma) t=2 cm	m2	20
34	Kripe	ton	4
35	Tabela per sinjalistiken rrugore 60*40	cope	5
36	Tabela per sinjalistiken rrugore Ø60	cope	10
37	Tabela per sinjalistiken rrugore 90*30	cope	4

Afatet e lëvrim: Afatet e levrimit: Nga dita e neserme e punes pas nenshkrimit te kontrates deri ne daten 31.12.2021 sipas kërkesave të ndërmarrjes

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006“Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës nëprocedurë këta ofertues me vlerat përkatëse tëofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janëskualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it _____
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra[_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor ngapërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojine specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atijqëtë prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japëpa pagesëAutoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

